

15 PRILL 2025



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKİYE CHAMBER OF COMMERCE

VLERËSIMI I PËRGJITHSHËM I EKONOMISË SË KOSOVËS 2024

T: +383 38 550 100
W: www.kt-to.org
E-mail: info@kt-to.org
A: Imzot Nike Prela
No.42, Ulpianë,
Prishtinë-KOSOVO





PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2024 ekonomia botërore vazhdoi të ketë përmirësime. Në përgjithësi, këtë vit, ekonomia globale mbeti e qëndrueshme, por sfida të tilla si inflacioni dhe tensionet gjeopolitike vazhduan.

Ekonomia e Kosovës shënoi rritje prej 4.6 përqind deri në shtator të vitit 2024, e mbështetur nga rritja e konsumit dhe investimeve, ndërsa importet neto ndikuan negativisht në aktivitetin ekonomik. Pra gjatë nëntë muajve të parë të vitit 2024, aktiviteti ekonomik është rritur me 4.6 përqind, falë rritjes eksportit të mallrave dhe shërbimeve për 9.6 përqind, investimeve për 7.6 përqind dhe konsumit për 3.1 përqind, ndërsa importi i mallrave dhe shërbimeve ndikoi negativisht duke u rritur për 9.2 përqind.

Vlerësimet e BQK-së sugjerojnë se ekonomia e Kosovës është rritur me 4.3 përqind gjatë vitit 2024, me kontribuues kryesor konsumin, investimet dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve. Ndërkohë, importi i mallrave dhe shërbimeve ka pasur ndikim të lartë negativ në rritjen e BPV-së.

Tremujori i tretë i vitit 2024 shënoi një rritje të çmimeve të konsumit me një vlerë mesatare prej 1.3% krahasuar me periudhën e njëjtë të një viti më parë. Kontribuuesit më të rëndësishëm në inflacion ishin kategoritë 'Ushqime dhe pije joalkoolike' dhe Pijet alkoolike dhe duhan', ndërsa kategoria 'përdorimi i pajisjeve për transport personal' vazhdoi të ketë kontribut negativ.

Parashikimet e BQK-së sugjerojnë se norma e përgjithshme e inflacionit pritet të jetë rreth 1.8% në vitin 2025. Presionet inflacioniste në çmimet e ushqimit në tregun vendor mbeten një nga faktorët kryesorë përcaktues të ecurisë së inflacionit; megjithëse, rënia e parashikuar e çmimeve të ushqimeve në tregjet ndërkombëtare mund të ushtrijë presion për rishikim të inflacionit për poshtë.

Përkundër kësaj, ecuria e inflacionit vazhdon të minohet kryesisht nga goditjet potenciale si pasojë e tensioneve gjeopolitike, kufizimeve tregtare dhe kushteve klimatike.

Eksporti i mallrave në vitin 2024 shënoi rritje prej 9.0 përqind, duke arritur në 941.2 milionë euro. Kjo rritje u mbështet kryesisht nga performanca pozitive në disa sektorë, me eksportin e metaleve bazë si kategoria më e rëndësishme e ndikuar nga rritja e kërkesës për metale në tregjet ndërkombëtare, pastaj eksporti i mallrave shënoi rritje edhe në produktet minerale dhe ato të plastikës dhe gomës.

Vlera totale e mallrave të importuara në vitin 2024 arriti në 6.3 miliardë euro, rritje vjetore prej 7.1 përqind. Kjo rritje është nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme, e cila u reflektua në rritje prej 11.9 përqind në sasinë e përgjithshme të mallrave të importuara. Importi i mallrave vazhdon të dominohet nga produktet minerale, makineritë dhe pajisjet shtëpiake si dhe artikujt ushqimorë.

IHD-të gjatë vitit 2024 shënuan rritje të madhe duke arritur vlerën prej 7.0 miliardë euro. Megjithatë, janë vërejtur rritje të konsiderueshme në disa sektorë. Rritje më e madhe është regjistruar në sektorin e patundshmërisë. Kjo rritje është ndikuar kryesisht nga çmimet e pasurive të paluajtshme dhe kërkesa në rritje për patundshmëri. Gjithashtu, IHD-të shënuan trend pozitiv në sektorët e aktiviteteve financiare, përfshirë sigurimet, si dhe në ndërtimtari dhe prodhim, duke reflektuar diversifikim dhe zhvillim të këtyre sektorëve.

Remitencat janë burim i rëndësishëm i ekonomisë së Kosovës duke mbështetur konsumin në vend. Në vitin 2024, vlera e remitencave të pranuar arriti në 1.3 miliardë euro, apo 15.0 përqind të BPV-së.




Megjithatë, rritja vjetore e remitencave u ngadalësua në vetëm 1.5 përqind, kundrejt rritjes prej 7.2 përqind në të njëjtën periudhë të vitit 2023. Sipas vlerësimeve të nxjera nga ana e BQK-së dhe ASK-së mund të thuhet se ekonomia e Kosovës ka pasur përmirësime të dukshme në rritjen ekonomike dhe në ngadalësimin e normës së inflacionit gjatë vitit 2024 dhe se pritet që me kontribuues kryesor konsumin, investimet dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve ekonomia e Kosovës do të rritet edhe më shumë gjatë vitit 2025 dhe se norma e inflacionit do të zbret në 1.8%.

RRITJA EKONOMIKE


Ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje të qëndrueshme dhe përmirësim të kushteve makroekonomike gjatë vitit 2024. Sipas vlerësimeve të ASK-së, BPV reale ka shënuar rritje prej 4.6 përqind deri në shtator 2024, e nxitur nga rritja e konsumit dhe investimeve, ndërsa eksportet neto ndikuan negativisht në aktivitetin ekonomik. Sipas vlerësimeve të BQK-së, ekonomia është rritur me 4.3 përqind gjatë tërë vitit 2024, me kontribuues kryesor konsumin, investimet dhe eksportin e mallrave dhe shërbimeve. Ndërkohë, importi i mallrave dhe shërbimeve ka pasur ndikim të lartë negativ në rritjen e BPV-së.

PBB NORMA REALE E RRITJES SIPAS VITEVE




Në tremujorin e fundit të vitit 2024, ekonomia e Kosovës ka shënuar rritje prej 4.0 përqind, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Rritja është nxitur kryesisht nga rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, investimeve si dhe nga rritja modeste e konsumit. Në anën tjetër, importet ndikuan negativisht aktivitetin ekonomik, për shkak të rritjes së kërkesës vendore dhe liberalizimit të vizave, që ka ndikuar në rritje të importit.

PBB NORMA REALE E RRITJES



Konsumi gjatë vitit 2024 është rritur për 3.1 përqind, duke shënuar rritje më të lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Kjo rritje është mundësuar nga rritja e burimeve të financimit, përfshirë rritjen e kredive konsumuese, kompensimit të punëtorëve, remitencave dhe rritjen e konsumit publik. Importi i mallrave të konsumit shënoi rritje prej 8.6 përqind, duke sugjeruar rritje të shpenzimeve të ekonomive familjare. Investimet shënuan rritje më të lartë prej 7.6 përqind, kryesisht si rezultat i rritjes së kreditimit dhe investimeve publike. Po ashtu, importi i mallrave kapitale dhe IHD-të në sektorin e patundshmërive shënuan rritje të konsiderueshme.

KONTRIBUESIT KRYESOR NË RRITJE TË PBB-SË





KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

Eksporti i mallrave gjithashtu është rritur me 9.6 përqind, kryesisht për shkak të rritjes së eksportit të metaleve bazë dhe minerale. Megjithatë, niveli i deficitit tregtar u thellua për 7.5 përqind, për shkak të nivelit më të lartë të importit, i cili shënoi rritje prej 7.6 përqind për mallra dhe 14.0 përqind për shërbime.

Rritja e aktivitetit ekonomik në tremujorin e fundit të vitit 2024 është mbështetur nga disa sektorë të ndryshëm. Sektorët që shënuan rritje më të lartë përfshijnë hotelerinë dhe restorantet, me rritje prej 6.3 përqind, e cila është ndikuar nga rritja e kërkesës për shërbime, si rezultat i ardhjes së diasporës gjatë verës.


Po ashtu, industria përpunuese shënoi rritje me 5.3 përqind, duke kontribuar në forcimin e eksporteve dhe prodhimit vendas. Ndërtimtaria shënoi rritje prej 3.6 përqind, si rezultat i investimeve në infrastrukturë dhe objekte rezidenciale, ndërsa tregtia u rrit me 3.1 përqind, për shkak të rritjes së konsumit dhe kërkesës për mallra. Bujqësia shënoi rritje prej 2.2 përqind, si rezultat i rritjes së rendimentit duke kontribuar në sigurinë ushqimore dhe stabilizimin e furnizimit me produkte bujqësore. Sektori i transporti dhe magazinimit shënoi rritje për 2.0 përqind, si rezultat i rritjes së kërkesës për shërbime logjistike.

Rritja e aktivitetit ekonomik në këta sektorë ka pasur ndikim të rëndësishëm në rritjen e numrit të ndërmarrjeve të regjistruara. Në TM4 2024, u regjistruan 2,953 ndërmarrje të reja, apo 3.5 përqind më shumë krahasuar me TM4 2023. Sektorë të prodhimit, bujqësisë, tregtisë, ndërtimtarisë dhe transportit regjistruan numrin më të madh të ndërmarrjeve të reja, duke reflektuar rritje të ndjeshme krahasuar me periudhë në njëjtë të vitit 2023, ndërsa sektorë të hotelërisë, aktiviteteve profesionale dhe arsimit shënuan numër më të vogël të ndërmarrjeve të regjistruara. Në anën tjetër, numri i ndërmarrjeve të mbyllura shënoi rritje për 2.7 përqind krahasuar me TM4 2023, duke arritur në 386 ndërmarrje.


ÇMIMET

Inflacioni në TM4 të vitit 2024 u ngadalësua në 0.7 përqind nga 1.3 përqind sa ishte në TM3 dhe 2.4 përqind në TM2 paraprak. Norma e inflacionit në shtator rezultoi 0.2 përqind, më e ulëta që nga janari i vitit 2021. Ndërsa në total nga të dhënat e marra prej ASK shohim se mesatarja vjetore e normës së inflacionit gjatë vitit 2024 ishte 1.6%.

INFLACIONI VJETOR, %



Rënia e inflacionit ishte rezultat i çmimeve më të ulëta të karburanteve, krahas ngadalësimit të rritjes së çmimeve të mallrave tjera jo-ushqimore. Në anën tjetër, kontributi i shërbimeve mbeti pothuajse i pandryshuar, kurse ai i ushqimit u rritë margjinalisht.





KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

Si rrjedhojë, u evidentua ngadalësim edhe i inflacionit bazë i cili përjashton çmimet e ushqimit dhe energjisë.

Çmimet e ushqimit shënuan rritje vjetore prej 1.2 përqind, që paraqet përshpejtim të lehtë kundrejt 1.1 përqind në tremujorin paraprak. Rritja e përshpejtuar e çmimeve të vajrave dhe yndyrave, bulmetit, dhe mishit ishin kontribuuesit kryesorë në përshpejtimin e inflacionit. Megjithatë, efekti i tyre u neutralizua pothuajse tërësisht nga rritja e ngadalësuar e çmimeve në nënkategoritë tjera të ushqimit dhe rënia e çmimeve të perimeve. Çmimet e karburanteve shënuan rënie vjetore prej 6.4 përqind duke reflektuar ecurinë rënëse të çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare. Në anën tjetër, çmimet e energjisë elektrike shënuan rritje vjetore prej 0.6 përqind duke u përshpejtuar kundrejt tremujorit paraprak kur u regjistrua rënie vjetore prej 0.1 përqind.

Zbutja e presioneve inflacioniste u reflektua edhe në ngadalësimin e inflacionit bazë në 3.3 përqind në TM3 2024 nga 3.6 përqind në tremujorin paraprak. Kjo tkurrje reflekton ngadalësimin e rritjes së çmimeve të shërbimeve të restoranteve, rekreacionit dhe kulturës, produkteve mjekësore dhe shërbimeve ambulantore, si dhe orendive, pajisjeve dhe shërbimeve për mirëmbajtjen e shtëpisë.

Sa i përket origjinës së inflacionit, u evidentua zbutje e presioneve të huaja inflacioniste, me kontributin e inflacionit të importuar që u tkurr në 1.0 nga 1.9 pikë përqindje në TM2 2024. Kjo tkurrje reflekton kryesisht rënien e çmimeve të karburanteve në tregjet ndërkombëtare dhe dinamikat e çmimeve të mallrave të importuara. Në anën tjetër, presionet e brendshme inflacioniste u tkurrën për vetëm 0.1 pikë përqindje duke rezultuar në rreth 0.4 pikë përqindje në TM3 2024.

Faktorët përcaktues të rënies së inflacionit të importuar u evidentuan edhe në indeksin e çmimeve të importit (IÇP), i cili rezultoi me rënie vjetore prej 0.7 përqind. Në anën tjetër, u evidentua rritje e indekseve që sinjalizojnë për koston e prodhimit të brendshëm si indeksi i çmimeve të prodhimit (IÇP) dhe i koston së ndërtimit (IKN).

Parashikimet e BQK-së sugjerojnë se norma e përgjithshme e inflacionit pritet të jetë rreth 1.8% në vitin 2025. Presionet inflacioniste në çmimet e ushqimit në tregun vendor mbeten një nga faktorët kryesorë përcaktues të ecurisë së inflacionit; megjithëse, rënia e parashikuar e çmimeve të ushqimeve në tregjet ndërkombëtare mund të ushtrojë presion për rishikim të inflacionit për poshtë. Përkundër kësaj, ecuria e inflacionit vazhdon të minohet kryesisht nga goditjet potenciale si pasojë e tensioneve gjeopolitike, kufizimeve tregtare dhe kushteve klimatike.

PUNËSIMI DHE PAGAT

Sipas të dhënave nga Administrata Tatimore e Kosovës gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024, ishin të punësuar mesatarisht 399,130 persona. Kjo paraqet një rritje vjetore prej rreth 1.7% (7,024 punëtorë më shumë). Kontributi më i madh në punësim vjen nga kategoria "Shërbimet administrative dhe mbështetëse" me 0.54% "Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave" me 0.43 % e ndjekur nga kategoria "Ndërtimtaria" me kontribut prej 0.33%.

TË PUNËSUARIT PRIMAR


	Të punësuar	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Pa Verifikuar
1	386,118	368,295	222,135	142,927	3,233
2	390,223	372,422	225,144	143,825	3,453
3	393,266	374,807	226,634	144,569	3,604
4	398,661	379,541	228,784	146,992	3,765
5	399,472	380,359	229,370	146,941	4,048
6	402,563	383,241	229,844	148,814	4,583
7	404,908	385,253	231,135	148,946	5,172
8	399,176	380,780	228,626	146,882	5,272
9	393,307	374,576	223,926	145,693	4,957
10	394,876	375,064	224,043	145,978	5,043
11	399,020	377,816	225,202	147,294	5,320
12	399,175	376,970	224,231	147,226	5,513

Të punësuarit sipas muajve të vitit 2024



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

PAGA MESATARE BRUTO, ATK




Sipas të dhënave të ATK-së në tremujorin e tretë të vitit 2024, paga mesatare bruto në vend shënoi një rritje vjetore prej 10.8% duke arritur në 650 euro. Në sektorin publik, paga mesatare pati një rritje vjetore prej 4.5% në 720 euro, kryesisht si rezultat i rritjes së vlerës së koeficientit të pagës, i cili përcaktohet me Ligjin e Buxhetit. Tek sektori privat, paga mesatare shënoi rritje vjetore prej 13.3% dhe arriti në 580, e cila kryesisht i atribuohet shtrëngimit të tregut të punës.

SEKTORI I JASHTËM

Në TM3 2024, deficitin tregtar të mallrave shënoi rritje prej 7.0 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit paraprak, duke arritur vlerën prej 1.4 miliardë euro. Kjo rritje reflekton zgjerim të importeve, të cilat arritën vlerën prej 1.7 miliardë euro, e ndikuar kryesisht nga rritja e sasisë së mallrave të importuara, veçanërisht produkteve minerale, makinerive dhe ushqimeve të përgatitura. Në anën tjetër, eksportet mbetën në nivel të ulët, duke arritur vlerën prej vetëm 247.2 milionë euro, duke mbuluar vetëm 14.6 përqind të importeve dhe duke krijuar raport tregtar të disfavorshëm. Niveli i ulët i eksporteve dhe varësia e lartë nga importet thelluan disbalancin tregtar, duke shfaqur sfidat e vazhdueshme në rritjen e kapaciteteve eksportuese, ndërkohë që kërkesa për importe mbetet e lartë, duke reflektuar varësinë nga tregjet ndërkombëtare për plotësimin e nevojave në vend.


Eksporti i mallrave në TM3 2024 shënoi rritje prej 16.0 përqind, duke arritur në 247.2 milionë euro.

EKSPORTI I MALLËRAVE, MILION EURO



Kjo rritje u mbështet kryesisht nga performanca pozitive në disa sektorë, me eksportin e metaleve bazë si kategoria më e rëndësishme, që shënoi rritje prej 21.5 përqind, duke arritur në 54.4 milionë euro, e ndikuar nga rritja e kërkesës për metale në tregjet ndërkombëtare.

KATEGORITË KRZESORE TË EKSPORTIT, MILION EURO




Pas metaleve, eksporti i mallrave shënoi rritje edhe në produktet minerale, duke arritur në 34.3 milionë euro, kryesisht për shkak të eksportit të energjisë elektrike (28.2 milionë euro). Eksporti i produkteve të plastikës dhe gomës pësoi rënie të lehtë prej 0.7 përqind, duke arritur vlerën prej 28.7 milionë euro.



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

Nga këndvështrimi gjeografik, Ballkani Perëndimor mbetet partneri kryesor i Kosovës në tregtinë ndërkombëtare, me 49.5 përqind të gjithsej eksporteve, ndërsa vendet e BE-së përbëjnë 31.5 përqind. Për më tepër, struktura e tregtisë së Kosovës është përmirësuar, duke zgjeruar shtrirjen e eksportit në gjithsej 120 shtete, nga 102 shtete në TM3 2023.


PARTNERËT KRYESOR TË EKSPORTIT



Partnerët kryesorë të eksportit për tërë vitin 2024 ishin; Shqipëria me 170 Milionë Euro, Maqedonia e Veriut me 143,9 Milionë Euro, Gjermania me 100,6 Milionë Euro, Zvicra me 86,3 Milionë Euro dhe Serbia me 53,2 Milionë Euro. Turqia këtë vit është renditur si partneri i dhjetë i Kosovës në eksport me vlerë totale prej 27,5 Milionë Euro.


Vlera totale e mallrave të importuara gjatë vitit 2024 arriti në 6.3 miliardë euro. Kjo rritje tregon një rritje vjetore prej 7.1 përqind.

IMPORTI I MALLËRAVE, MILION EURO




Kjo rritje është nxitur kryesisht nga kërkesa e brendshme, e cila u reflektua në rritje prej 11.9 përqind në sasinë e përgjithshme të mallrave të importuara. Importi i mallrave vazhdon të dominohet nga produktet minerale, makineritë dhe pajisjet shtëpiake si dhe artikujt ushqimorë.

KATEGORITË KRZESORE TË IMPORTIT, MILION EURO



Struktura sipas kategorive kryesore të importit u dominua nga mallrat e ndërmjetme, që përbëjnë 43.8 përqind (47.4 përqind në TM3 2023), mallrat konsumuese 34.4 përqind dhe mallrat kapitale që përbëjnë vetëm 11.7 përqind të importit të përgjithshëm.

PARTNERËT KRYESOR TË IMPORTIT



Vendet e BE-së përfaqësojnë rreth 43.5 përqind të importeve, me Gjermaninë që mban peshën kryesore me 13.9 përqind të importit të përgjithshëm. Importi nga Turqia përfaqëson 14.5 përqind të gjithsej importit, e ndjekur nga Kina me 13.2 përqind.



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE


Importi nga vendet e rajonit përbën 12.2 përqind të gjithsej importit, duke shënuar rënie krahasuar me TM4 2023 (15.6 përqind), kryesisht për shkak të rënies së importit nga Maqedonia e Veriut, ku importi i vajrave motorike u zvogëlua për 11.4 milionë euro krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak.

Bilanci i shërbimeve në TM3 2024 arriti vlerën prej 958.4 milionë euro, duke shënuar rritje prej 9.2 përqind, e mbështetur nga performanca pozitive në disa sektorë. Eksporti i shërbimeve arriti vlerën prej 1.5 miliardë euro apo 11.4 përqind rritje vjetore, e nxitur kryesisht nga rritja e shërbimeve të udhëtimit, që arritën vlerën prej 1.3 miliardë euro (43.6 përqind e BPV-së), e ndikuar kryesisht nga rritja e numrit të udhëtarëve. Rritja e eksportit të shërbimeve u ndikua edhe nga rritja e shërbimeve kompjuterike, prej 32.6 përqind, duke arritur vlerën 93.9 milionë euro. Po ashtu, shërbimet e tjera të biznesit kanë kontribuar me rritje të theksuar prej 49.1 përqind, duke arritur vlerën prej 70.6 milionë euro. Rritja e vazhdueshme e eksportit të shërbimeve të IT-së dhe shërbimeve të tjera të biznesit është tregues i rëndësishëm i transformimit të sektorit të shërbimeve dhe diversifikimit të eksportit.

REMITENCAT


Remitencat janë burim i rëndësishëm i ekonomisë së Kosovës duke mbështetur konsumin në vend.

REMITENCAT TM1-TM4 2024



Gjatë TM1 vlera e remitencave të pranua ishte 281,1 milion euro, në TM2 ishte 349 milion euro në TM3 ishte 380,7 milion euro ndërsa në TM4 344,2 milion euro. Kosova pranoi remitencat me vlerë më të madhe gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024 pra muajve të verës ku diaspora kosovare vjen për pushime në Kosovë.

REMITENCAT SIPAS VITEVE



■ Bankalar/ Bankat ■ Acenteler/ Agjencitë ■ Diğer/ Tjera


Megjithatë, rritja vjetore e remitencave u ngadalësua në vetëm 0.8 përqind, kundrejt rritjes prej 9.9 përqind në të njëjtën periudhë të vitit 2023. Ky ngadalësim mund të jetë pasojë e pasigurisë ekonomike dhe inflacionit ende të lartë në vendet ku jeton dhe punon diaspora kosovare, duke reduktuar mundësinë e tyre për të dërguar remitenca. Gjermania dhe Zvicra vazhdojnë të jenë burimet kryesore të remitencave, të cilat përbëjnë 56.3 përqind të gjithsej remitencave, e ndjekur nga SHBA-të dhe vendet tjera të BE-së. Remitencat përmes kanaleve formale, si bankat dhe agjencitë për transferim të parave, shënuan rritje prej 1.3 përqind, ndërsa remitencat përmes kanaleve joformale shënuan rrënje prej vetëm 0.5 përqind.

Rritja e ngadalësuar sipas kanaleve zyrtare mund të jetë ndikuar nga liberalizimi i vizave, i cili ka mundësuar vizita më të shpeshta të kosovarëve tek familjarët e tyre në vendet e BE-së. Ky ndryshim ka mundësuar dërgimin e remitencave fizikisht gjatë këtyre vizitave dhe duke rezultuar në raportim më të kufizuar të remitencave.



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

REMITENCAT SIPAS SHTETEVE




Remitencat e regjistruara gjatë tërë vitit 2024 ishin në një vlerë prej 1,3 miliardë euro. Dërgesa më të mëdha të këtyre remitencave janë bërë nga Gjermania me 37.5% apo 510.2 milionë euro, nga Zvicra me 18.0% apo 251.6 milionë euro, nga SH.B.A. me 7.4% apo 100.8 milionë euro dhe nga Austria me 4.7% apo 61.96 milionë euro.

INVESTIMET E HUAJA DIREKTE

IHD-të gjatë vitit 2024 shënuan rritje të konsiderueshme prej 1.1 përqind, duke arritur vlerën e 847.0 milionë euro,


INVESTIMET E HUAJA DIREKTE



Këto rritje të konsiderueshme janë vërejtur në disa sektorë. Rritje më e madhe është regjistruar në sektorin e patundshmërisë, ku investimet u rritën me 24.5 përqind, duke arritur në 190.3 milionë euro në TM3-2024. Kjo rritje është ndikuar kryesisht nga çmimet e pasurive të paluajtshme dhe kërkesa në rritje për patundshmëri.

Gjithashtu, IHD-të shënuan trend pozitiv në sektorët e aktiviteteve financiare, përfshirë sigurimet, si dhe në ndërtimtari dhe prodhim, duke reflektuar diversifikim dhe zhvillim të këtyre sektorëve.

IHD SIPAS AKTIVITETEVE, MILION EURO



Ndërkohë, investimet direkte të rezidentëve kosovarë në vendet e tjera shënuan rënie prej 12.4 përqind në TM3 2024, duke arritur në 52.7 milionë euro, kryesisht të orientuara në sektorin e patundshmërisë në vendet e rajonit.

INVESTIMET KUMULATIVE, MILION EURO




Investimet e Huaja Direkte Kumulative në dhjetor të vitit 2024 arritën vlerën e 7 miliardë e 57 milion Euro me sektorin e patundshmërisë si kontribuesi kryesor.



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

IHD SIPAS VENDEVE, MILION EURO




Investimet e Huaja Direkte Kumulative më të mëdha sipas shteteve deri në dhjetor të vitit 2024 janë si në vijim : Gjermania me 1.2 miliardë euro, Zvicra me 1.1 miliardë euro, SHBA me 542.0 milionë euro, Turqia me 519.1 milionë euro, Shqipëria me 468.3 milionë euro si dhe Austria me 338.8 milionë euro.

IHD nga Gjermania dhe Zvicra janë kryesisht investime të bëra në sektorë të patundshmërisë, ndërsa investimet nga Turqia të alokuar në sektorë real si sektorin e energjisë, të financave, shërbimeve, prodhimit, logistikës dhe janë investime që ndikojnë drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit.

SEKTORI BANKAR


Asetet e sektorit bankar deri në muajin shtator të vitit 2024 arritën në 7.97 miliardë euro, duke shënuar një rritje vjetore prej 11.2 përqind. Kreditimi shënoi rritje vjetore prej 15.1 përqind, të përshpejtuar për 1.8 pikë përqindje krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit paraprak. Kreditë për ekonomitë familjare shfaqën një përshpejtim të ndjeshëm, ndërsa kreditë për korporatat jo-financiare vazhduan të rriten me ritëm të ngjashëm me vitin paraprak.

STOKU I GJITHSEJ KREDIVE, NDRYSHIMI VJETOR



Ndonëse struktura e kredive vazhdon të dominohet nga kreditë ndaj korporatave jofinanciare, me pjesëmarrje prej 58.7 përqind të gjithsej stokut të kredive të sektorit bankar, kreditë ndaj ekonomive familjare janë duke zgjeruar gradualisht pjesëmarrjen si rezultat i ritmit relativisht më të shpejtë të rritjes. Kjo tendencë po nxitet kryesisht nga zgjerimi i kredive për ekonomitë familjare me maturime më afatgjata, duke reflektuar kërkesën në rritje për kredi për blerje të patundshmërive dhe investime të tjera kapitale.

KONTRIBUTI NË RITJEN E GJITHSEJ KREDIVE %




Në të njëjtën kohë, struktura e maturimit të kredive për korporatat jo-financiare mbeti e pandryshuar krahasuar me vitin e kaluar, duke sinjalizuar një stabilitet në modelet e financimit të këtij segmenti.



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

Segmenti i ekonomive familjare shënoi rritje vjetore të përshpejtuar të stokut të kredive në 20.8 përqind nga 17.3 përqind në vitin paraprak. Krahas rritjes së volumit, struktura e maturimit të kredive pësoi një ndryshim gradual, duke reflektuar një zhvendosje drejt kredive me afat më të gjatë dhe shuma më të larta.

STOKU I GJITHSEJ DEPOZITAVE




Vlera e depozitave në sektorin bankar arriti në 6.51 miliardë euro, duke shënuar rritje vjetore prej 11.2 përqind, pothuajse e njëjtë me rritjen prej 11.3 përqind të regjistruar një vit më parë. Në përputhje me sezonalitetin tipik të kësaj periudhe, depozitat shënuan rritje më të lartë krahasuar me tremujorët paraprak të këtij viti ndaj dhe ndërruan trendin e gjysmës së parë të vitit që u karakterizua me ngadalësim vjetor të rritjes.

Depozitat e ekonomive familjare, që përfaqësojnë rreth 64.5 përqind të gjithsej portfolios së depozitave, shënuan rritje vjetore lehtësisht të ngadalësuar në 8.0 përqind nga 9.0 përqind në vitin paraprak. Ngjashëm, depozitat prej korporatave jo-financiare shënuan rritje vjetore prej 14.4 përqind nga 14.9 përqind. Ndërsa, depozitat e korporatave publike shfaqën një përshpejtim të theksuar, duke u rritur me 51.6 përqind në krahasim me vetëm 1.4 përqind në vitin e kaluar. Ky zhvillim është ndikuar kryesisht nga depozituesit e mëdhenj, të cilët përfaqësojnë një pjesë të konsiderueshme të rritjes në këtë kategori, veçanërisht nga sektori i energjisë.

Ky fenomen ka pasuar ofertat e bankave për norma interesi më të favorshme, të cilat janë ofruar për të tërhequr depozituesit institucionalë, për shkak të nevojës për likuiditet në sektorin bankar. Në tremujorin e tretë të vitit 2024, ashtu sikurse në periudhën e njëjtë të vitit paraprak, depozitat përbënin 81.7 përqind të gjithsej detyrimeve dhe ekuitetit të sektorit bankar.

NORMA E INTERESIT NË KREDI DHE DEPOZITA



Lehtësimi i politikës monetare nga Banka Qendrore Evropiane dhe ulja e presioneve inflacioniste kanë ndikuar në zbutjen e presioneve për normat e interesit në sektorin bankar në vend si dhe ndërprerjen e trendit rritës të peshës së kredive me normë të ndryshueshme interesi.

Ulja e normës së interesit nga BQE është reflektuar në uljen e normës së interesit në kredi, si për segmentin e ekonomive familjare edhe për segmentin e korporatave jo-financiare. Në shtator të vitit 2024, norma e interesit në kredi zbriti në 6.1 përqind nga 6.5 përqind sa ishte një vit më parë. Ndërsa, konkurrenca e lartë ndërbankare për tërheqje të depozitave ndikoi në rritjen tutje të normës së interesit të depozitave. Ajo arriti në 2.9 përqind nga 2.4 përqind vitin paraprak, duke shënuar normën më të lartë të interesit në depozita në dhjetë vitet e fundit për këtë periudhë raportuese. Si rezultat i uljes së normave të interesit në kredi dhe rritjes së normës së interesit në depozita, margjina e interesit kredi-depozitë është ngushtuar duke zbritur në 3.2 pikë përqindje në shtator 2024 nga 4.1 pikë përqindje në shtatorin e vitit paraprak.



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

PRITSHMËRITË EKONOMIKE PËR VITIN 2025

-Pavarësisht presioneve inflacioniste në tregjet ndërkombëtare, rritja reale e PBB-së arriti në 4.5% gjatë vitit 2024, e mbështetur nga performanca pozitive e eksportit të shërbimeve dhe konsumit të lartë privat.

-Nëse vazhdon trendi pozitiv i eksportit të shërbimeve, rritet niveli i investimeve në kapitalin njerëzor dhe përfshihen më shumë gra joaktive në tregun e punës, Banka Botërore parashikon që Kosova me një rritje prej 4.0% në vitin 2025 mund të jetë vendi me rritjen më të madhe ekonomike në rajon pas Serbisë.

-Sipas parashikimeve të BQK-së, inflacioni ka vazhduar trendin e ngadalësimit dhe nga 5% në vitin 2023, ka rënë në 1.6% në vitin 2024 – nën pritjet fillestare prej 3.0%. BQK parashikon që në vitin 2025 inflacioni të jetë 1.8%, por varësia e lartë e Kosovës nga importi mund ta ekspozojë vendin ndaj luhatjeve të çmimeve ndërkombëtare. Luftërat tregtare, pritjet për recesion në SHBA dhe Evropë, dhe pasiguritë tjera mund të ndikojnë negativisht në rritjen ekonomike.

-Luftërat tregtare, veçanërisht për vende si Kosova që janë të varura nga jashtë, shkaktojnë pasoja negative indirekte si: rritja e kostove të importit, ndërprerje të zinxhirit të furnizimit, presion mbi eksportet, dhe pasiguri në kanalet e investimeve.

-Si përfundim, edhe pse ekonomia e Kosovës tregon një trend pozitiv të rritjes për vitin 2025, zbatimi i reformave strukturore dhe tejkalimi i sfidave ekzistuese në treg janë thelbësore për zhvillim të qëndrueshëm.

SI MUND TË NDIKOHET KOSOVA NGA LUFTËRAT TREGTARE?

1. Rritja e Kostove të Importit

Kosova importon shumë produkte thelbësore nga jashtë:

- Ka një varësi të lartë nga importi për artikuj si ushqim, energji, makina, elektronikë dhe materiale ndërtimi.
- Në rast të luftërave tregtare mes ekonomive të mëdha dhe rrjedhimisht problemeve të zinxhirit të furnizimit global, Kosova mund të detyrohet t'i blejë këto produkte me çmime më të larta.
- Kjo rrit inflacionin dhe ul fuqinë blerëse të qytetarëve.

2. Ndërprerjet në Zinxhirët e Furnizimit

Kosova nuk ka eksport të dendur drejtpërdrejt me aktorë të mëdhenj si SHBA apo Kina, mirëpo importi i lartë nga Kina dhe produktet të cilat përdoren si lëndë e parë mund të kenë ndërprerje. Gjithashtu;

- Kosova mund të ndikohet në mënyrë të tërthortë përmes BE-së (sepse BE është partneri më i madh tregtar i Kosovës).
- Nëse zinxhirët e furnizimit të BE-së preken, mund të ketë vonesa dhe rritje të kostove për produktet që vijnë në Kosovë.



KOSOVA TÜRKİYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TURKEY CHAMBER OF COMMERCE

3. Presione mbi Eksportin

Eksporti i Kosovës është i kufizuar, por produktet ekzistuese—si ato bujqësore, disa produkte tekstili apo industriale—mund të jenë më të vështira për t'u shitur nëse bie kërkesa globale:

- Luftërat tregtare shpesh çojnë në ngadalësim ekonomik global.
- Kjo ul konsumin dhe kërkesën për import në Evropë apo vende të tjera → Kërkesa për produktet e Kosovës bie.

4. Efektet në Valutë dhe Investime

- Kosova përdor Euron, por është ekonomikisht e varur nga jashtë. Gjatë luftërave tregtare, investorët priren të orientohen drejt tregjeve më të sigurta.
- Kjo mund të çojë në ulje të investimeve të huaja direkte në Kosovë.
- Gjithashtu, ndihmat ndërkombëtare ose mekanizmat e kredisë mund të bëhen më të vështira për t'u arritur.

A Ka Mundësi që Kosova të ketë ndonjë përfitim nga kjo situatë?

Ka, por janë të kufizuara:

- Nëse vendet e BE-së kërkojnë alternativa ndaj prodhuesve si Kina, disa prodhues të vegjël në Kosovë mund të përpiqen të zënë një hapësirë të vogël nga kjo kërkesë.
- Nëse nxitet prodhimi vendor, mund të ketë një orientim më të madh drejt tregut të brendshëm për ushqim ose produkte të thjeshta konsumi.

Por për këtë nevojitet zhvillim serioz në infrastrukturë, investime dhe kapacitete prodhuese.

**Vlerësimi në këtë raport është bazuar në të dhëna të marra nga institucione të ndryshme. Burimi: ASK (Agjencia e Statistikave të Kosovës), BQK (Banka Qendrore e Kosovës), ATK (Administrata Tatimore e Kosovës), MFPT (Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve) dhe WB (Banka Botërore).*





KOSOVA TÜRKiYE TİCARET ODASI
ODA TREGTARE KOSOVARO TURKE
KOSOVO TÜRKiYE CHAMBER OF COMMERCE